

VENDIM
Nr. 576, datë 31.8.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike, Elbasan”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 713 832 (nëntë milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 713 832 (nëntë milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh, përballohet nga Bashkia Elbasan.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Elbasan.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.
 8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Elbasan.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimi i aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, ELBASAN”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			
														“ARË”			VLERA TOTALE (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Arë” (m²)	“Truall” (m²)	“Ndërtesë” (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
1	ALKETA	PETRIT	LATIFI	ELBASAN	8527	207/1	Arë	5193	5193	0	0	2	73	2,025	222	449,550	449,550
	ANDEL	PETRIT	HARJA														
	DALLENDYSHE	XHAFERR	PERIHANA														
	DASHUNI	BEHEXHET	HARJA														
	ZHANETA	MUSTAFA	MITARJA														
	BEHIJE	RIZA	DAIU														
	RUDMIRA	MUHAMET	SEFERI														
	ISUF	MUHAMET	DAIU														
	GENTIAN	MUHAMET	DAIU														
2	BEQIR	BUKUROSH	SEJDINI	ELBASAN	8527	220/1	Arë	17860	17860	0	0	2	88	12,281	222	2,726,382	2,726,382
	DASHAMIRA	BUKUROSH	SEJDINI														
	DHURATA	BUKUROSH	SEJDINI														
	NEKTAR	BUKUROSH	SEJDINI														
	SOPOT	BUKUROSH	SEJDINI														
3	OSMAN	HAXHI	KULLA	ELBASAN	8527	223/1	Arë	12300	12300	0	0	2	74	11,280	222	2,504,160	2,504,160
4	DURIM	SHEFIK	KULLA	ELBASAN	8527	227/6	Arë	17640	17640	0	0	2	84	17,640	222	3,916,080	3,916,080
	ZEJNEP	SHEFIK	TRUNGU														
	BESNIK	SHEFIK	KULLA														
5	ZHANETA	MUSTAFA	MITARJA	ELBASAN	8527	206/2	Arë	2594	2594	0	0	2	79	530	222	117,660	117,660
	BEHIJE	RIZA	DAIU														
	ANDEL	PETRIT	HARJA														
	ALKETA	PETRIT	LATIFI														
	DASHUNI	BEHEXHET	HARJA														
	DALLENDYSHE	XHAFERR	PERIHANA														
	RUDMIRA	MUHAMET	SEFERI														
	ISUF	MUHAMET	DAIU														
	GENTIAN	MUHAMET	DAIU														
SHUMA TOTALE																9,713,832	9,713,832